

VENDIM
Nr. 798, datë 9.11.2016

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT
“NDËRTIMI I SHKOLLËS “KOSOVA””, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, dhe të neneve 5, pika 1, 20 dhe 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i shkollës “Kosova””, Tiranë”.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Tiranë.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “truall” dhe “ndërtesë”, me vlerë të përgjithshme 165 312 977 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë milionë e treqind e dymbëdhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekësh.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 165 312 977 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë milion e treqind e dymbëdhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekësh, të përballohet nga llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.
 5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.
 6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.
 7. Pronarët e listës që i bashkëlidhen këtij vendimi të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Tiranë.
 8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.
 9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë, për pasuritë e shpronësuara.
 10. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

LLOGARITJET PARAPRAKE PËR PASURITË QË PREKEN NGA PROJEKTI
“NDËRTIMI I SHKOLLËS “KOSOVA”“

Nr.	EMËR MBIEMËR	Zona kadast.	Nr. i pasurisë	SIP. tr. të prekur (m ²)	Çmimi i truallit lekë/m ²	SIP. Obj. të prekur (m ²)	Çmimi Obj. lekë/m ²	Vlera në lekë	Konfirmimi i ZVRPP-së, Tiranë
1	Bashkpron. Grabocka, Kapo, Zere.	8160	2/76	2468,5	66,969	145	0	165.312.977	Shkr.nr. prot.9049/1, datë 18.4.16 Shkr. nr. prot.9049/3, datë 6.6.16
Shuma								165.312.977	lekë

1. Për truallin, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja 89, datë 3.2.2016.
2. Për ndërtesat, vlerësimi është bërë sipas VKM-së nr. 138, datë 23.3.2000 (i ndryshuar) dhe sipas çmimeve të EKB-së, për vitin e ndërtimit dhe amortizimin.